

VENDIM
Nr.266, datë 18.3.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “UNAZA SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9636, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Shkodër”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objektet, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 47 826 458 (dyzet e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpronësimi të fillojë më 18.3.2009 dhe të përfundojë më 30.6.2009.
 6. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmimi ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet e nevojshme, për përputhshmërinë e objekteve, të cilat preken, me numrat e pasurive në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lista e objekteve që duhet të shpronësohen, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Shkodër”

Nr.	Emri i objektit	Emri pronarit	Zona kadastrale	Nr.pasurisë	Sip. e ndërtimit	Çmimi për m ²	Vlera e llogaritur (lek)	Shënime
1	Shtëpi banimi 1 kate	Familja Hoxha	8591	3/301	75	43870	3290250	Konf.ZVRPP
2	Shtëpi banimi 1 kate	Kujtim Ferhati	5891	6/761	98	43870	4299260	Konf.ZVRPP
3	Shtëpi banimi 2 kate	Mersin Jahja	5891	6/308	183.5	43870	8050145	Konf.ZVRPP
4	Shtëpi banimi 1 kate	Shefqet Kruja	5891	6/739	56.3	43870	2469881	Konf.ZVRPP
5	Shtëpi banimi 1 kate + bodrum	Medi Duda	5891	6/616	114	43870	5001180	Konf.ZVRPP
6	Shtëpi banimi 1 kate + bodrum	Mithat Duda	5891	6/700	88.7	43870	3891269	Konf.ZVRPP
7	Shtëpi banimi 1 kate + dyqan	Ahmet Osja	5891	13/343	94.9	43870	4163263	Konf.ZVRPP
8	Shtëpi banimi 1 kate	Xhavit Jakupi	5891	13/375	120	43870	5264400	Konf.ZVRPP
9	Shtëpi banimi 1 kate	Selaudin Jakupi	5891	13/373	33	43870	1447710	Konf.ZVRPP
10	Dyqan 1 kate	Petrit Barbullushi	5891	8/435	28.6	43870	1254682	Konf.ZVRPP
11	Shtëpi banimi 1 kate	Fadil Pirani	8592	5/89	92	41481	3816252	Konf.ZVRPP
12	Garazh	Smajl Shyti	8592	7/77,529	32	41481	1327392	Konf.ZVRPP
13	Shtëpi banimi 1 kate	Tefik Pirani	8592	5/217	85.6	41481	3550774	Konf.ZVRPP
	Shuma				1101.6		47826458	

